VENDIM
Nr.126, datë 14.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME KONCESION, TË HIDROCENTRALIT "EGNATIA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Egnatia".
2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha